VENDIM
Nr. 225, datë 26.10.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË OST SHA, PËR DISA NDRYSHIME NË "RREGULLOREN PËR PROCEDURAT E BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETET E SHPËRNDARJES DHE TË TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN DHE SHITJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR TË SIGURUAR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË SHËRBIMIT PUBLIK"

Në mbështetje të nenit 16, nenit 19, germa "l" dhe nenit 56, germa "f", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, "Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", të ndryshuar, dhe "Rregullave të tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 214, datë 28.12.2017, nenit 19, pika "f" dhe nenit 26 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.10.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e hartuar nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a., për disa ndryshime në "Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik",

konstatoi se:

- OST sh.a., me shkresën nr. 2167/4 prot., datë 8.10.2018, ka kërkuar nga ERE disa ndryshime në "Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik".

- OST sh.a., me shkresën nr. 2167/4 prot., datë 9.10.2018, ka vijuar korrespondencën lidhur me këto ndryshime, referuar edhe shkresës së Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë me nr. 28 prot., datë 26.9.2018, nëpërmjet së cilës ka kërkuar rishikimin e vendimit e Bordit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, të ndryshuar, i cili ka miratuar "Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik".

- Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë AEES, nuk legjitimohet si palë propozuese për të kërkuar ndryshime në "Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik", ku palë janë OST sh.a. dhe OSHEE sh.a., bazuar në nenet 62 dhe 69 të ligjit nr. Ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- Kërkesa për interpretim të dispozitave dhe të ndryshime në këtë rregullore është shtruar edhe më herët nga OST sh.a., me shkresat nr. 6393/1, datë 11.12.2017; nr. 2167 prot., datë 11.4.2018 dhe nr. 2167/3 prot., datë 8.5.2018, por ERE, nëpërmjet shkresave nr. 747/2, datë 21.12.2017; nr. 259 prot., datë 13.3.2018 dhe nr. 259/2 prot., datë 18.4.2018, i ka kërkuar OST sh.a. të paraqesë për shqyrtim propozime konkrete të kërkesës për ndryshime.

- OST sh.a. kërkon. që për analogji edhe me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, të mund të konsiderohet i vlefshëm procesi me një ofertë të vlefshme.

- Kjo rregullore paraqet formë të thjeshtëzuar të procedurave të prokurimit publik. Rregullorja është draftuar në konsulencë me Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë ENC. Gjithashtu, kjo rregullore paraqet

procedura edhe për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve nga operatori i shpërndarjes së energjisë OSHEE sh.a. (sot OSSH sh.a.), kështu marrja e opinionit të OSSH sh.a. dhe Sekretariati të Komunitetit të Energjisë ENC. në lidhje me ndryshimet e kërkuara nga OST sh.a. konsiderohet e nevojshme në këtë proces.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a. mbi disa ndryshime në "Rregulloren për procedurat e blerjes se energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik", si më poshtë:

Në nenin 15 të "Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik", propozohet të shtohet:

- Në rastin e përsëritjes së procesit, procesi të zhvillohet i njëjtë me atë fillestar dhe procedura të përsëritet aq herë sa është e nevojshme për arritjen e qëllimit, të blerjes së sasisë së nevojshme të energjisë.
- Procesi mund të konsiderohet i vlefshëm dhe me një ofertë të vlefshme.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë OST sh.a., OSHEE sh.a, AAES dhe Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti